



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

RAPORT I PUNËS

01 JANAR – 31 DHJETOR 2020

JANAR 2021

[1]

Raporti pasqyron aktivitetet e punëve që janë ndërmarr gjatë periudhës vjetore të vitit 2020 deri më 31.12.2020 në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Në kuadër të kësaj drejtorie fillimisht është përgatitur plani i punës për vitin 2020 në bashkëpunim me të gjithë stafin e kësaj drejtorie . Në fillim të vitit 2020 në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa kanë qenë të punësuar dhjetë zyrtarë dhe Drejtoresha.

1. Drejtoresha për Buxhet dhe Financa
2. Shefi i Sektorit për Buxhet dhe Financa – Zyrtari Shpenzues
3. Zyrtari i Lartë për Buxhet dhe Financa
4. Menaxheri i Tatim në Pronë
5. Zyrtari për Buxhet – Çertifikuesi
6. Operatorja për futjen e të dhënave.
7. Zyrtari për te Hyra
8. Anketuesi 1,
9. Anketuesi 2,
10. ZKF,
11. Zyrtari për vlerësimin e pronës se paluajtshme

Vlenë të ceket se me 1 Qershor është pranuar një praktikante e përzgjedhur dhe financuar nga Organizata Anibar në një afat kohorë prej tre muaj, dhe e cila është e vendosur në zyrën për Buxhet dhe Financa, ndersa i eshte vazhduar praktika edhe 3 muaj tjere pa pagese..

Drejtoria në përgjithësi operon me dhjetë punëtorë të ndarë në këto sektorë :

- **Spektori për buxhet**
- **Spektori për financa**
- **Spektori i tatimit në pronë**

- Sektorin për Buxhet e përbejnë këta zyrtare :**Shefi i sektorit, Zyrtari shpenzues,Zyrtari Certifikues dhe Aprovues i shpenzimeve.**
- Sektorin për Financa përbejnë këta zyrtare : **ZKF, Zyrtari Zotues dhe Zyrtari për te hyra .**
- Sektorin për Tatim ne prone e përbejnë këta zyrtare : **Menaxheri i tatimit ne prone , Operatori për futjen e te dhënave, Anketuesi, Zyrtar për vlerësimin e**

pronës se paluajtshme, si dhe ne fillim te muajit Shtator është angazhuar me kontrate ne vepër edhe zyrtari Anketues pran zyrës se tatimit ne prone.

Të arriturat kryesore për këtë Drejtori gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2020 janë:

❖ Sektori për Buxhet

- Përpilimi i planit te punes nga te gjithë punetoret per vitin 2020.
- Përpilimi i pasqyrave financiare te Komunës Junik për vitin 2019 dhe dorëzimi i tyre në MF pas barazimit të tyre me pasqyrat e free balancit.
- Përgatitja dhe barazimi i raportit te shpenzimeve te vitit 2019, me MF – Thesar.
- Përgatitja dhe barazimi i raportit tremujore, gjashtemujore, nentemujore dhe vjetore te shpenzimeve te vitit 2020, me MF – Thesar.
- Përpilimi i planit të rrjedhës së parasë per vitin 2020 (cash flow) për të gjitha programet buxhetore të Komunës Junik në bashkëpunim me Drejtoritë tjera dhe dorëzimi i tyre në Thesar MF .
- Autorizimet dhe delegimet e përgjegjësive për menaxhim dhe shpenzim te buxhetit , zyrtari zotues , zyrtaret autorizues, zyrtari certifikues,zyrtari i të hyrave – deponimi i nënshkrimeve ne Thesar.
- Përgatitja e raporteve mujore dhe tremujorit te pare, te dyte, te trete dhe vjetore të shpenzimeve për te gjitha programet e Komunës për vitin 2020.
- Përgatitja e raportit financiar te shpenzimeve për tre mujorin e pare, te dyte, te trete dhe vjetor për Komunën e Junikut për vitin 2020.
- Përgatitja e Analizës se raporteve financiare për tremujorin e pare, te dyte, te trete dhe vjetor te vitit 2020.

- Përgatitja e raportit të punës për komplet drejtorinë për buxhet dhe financa për të gjitha sektorët për periudhën janar – mars, janar-qershor, janar-shtator, dhe janar-dhjetor 2020.
- Përgatitja e raportit sipas kodeve ekonomike për të gjitha programet e Komunës Junik për periudhën vjetore 2020.
- Përgatitja e Listës të borxheve Komunale ndaj subjekteve dhe operatoreve të ndryshëm ekonomik.
- Evidentimin dhe regjistrimin i të gjitha faturave të pranuar në Komunën e Junikut dhe shpërndarja në drejtoritë përkatëse
- Regjistrimi i të gjitha alokimeve mujore buxhetore konform planit vjetor të rrjedhjes së parasë së gatshme.
- Janë menaxhuar të gjitha lëvizjet e stafit në listat e pagave për të gjitha programet buxhetore komunale.
- Përgatitja e Rrjedhës së parasë (Kesh Planit) për disa projekte kapitale dhe dorëzimi i tyre në Ministrinë e Financave dhe Transfereve përkatësisht departamentin e thesarit.
- Është përgatitur Raporti Vjetor Financiar mbi të hyrat dhe shpenzimet për vitin fiskal 2019 për Kryetarin e Komunës.
 - Regjistrimi i transfereve të ndryshme nga donatorët e jashtëm sipas marrëveshjeve të nënshkruara me Komunën e Junikut.
 - Mbikëqyrja e Alokimeve të hyrave vetanake në sistemin Free-balance.
- Fillimi i procedurave për planifikimin e projekt buxhetit për periudhën buxhetore 2021/2023.
- Përpilimi i KAB-it Komunal 2021/2023 në bashkëpunim me përgjegjësit e programeve buxhetore.
- Planifikimi i projekt buxhetit për periudhën buxhetore 2021/2023 në bashkëpunim me të gjitha programet buxhetore.
- Janë futur në sistemin BDMS dhe PIP të gjitha të dhënat buxhetore për vitin 2021 sipas drejtorive, dhe kodeve ekonomike.
- Koordinimi i aktiviteteve për fazën fillestare të auditimit për vitin 2020 nga Auditorët e Jashtëm
 - Regjistrimi i transfereve të ndryshme nga donatorët e jashtëm sipas marrëveshjeve të nënshkruara me Komunën e Junikut.
- Nisja e procedurave për planifikimin e Buxhetit për vitin 2021/2023, pas pranimit të qarkores së parë Buxhetore 2021/01 dhe të dytë.

- Perpilimi i KABI-it Komunal 2021/2023 per te gjitha programet buxhetore te Komunes Junik.

❖ **Sektori për Financa**

- Përgatitja dhe barazimi i raportit të hyrave për vitin 2019 ne MF – Thesar.
- Regjistrimi i të gjitha të hyrave komunale në sistemin e free balancit nga të gjitha programet si psh: (Administrata, Buxhet dhe Financa , Urbanizëm, Shëndetësi, Shërbimet Publike, Zhvillim Ekonomik) varësisht nga llojet e të hyrave dhe po ashtu barazimet mujore dhe alokimet e të hyrave vetanake te cilat janë bërë ne Thesar – MF, për vitin 2020.
- Përgatitja e raporteve mujore, tremujore, gjashtemujore dhe vjetore te të hyrave për te gjitha programet e Komunës për vitin 2020.
 - Zotimi i mjeteve për të gjitha programet e Komunës Junik sipas kërkesave të Drejtorive, ku gjithsejtë janë bërë **1,106** zotime ne periudhën Janar-Dhjetor **2020** .Ku **788** - zotime në Modulin e Aprovimeve si dhe **318**- zotime në Modulin e Blerjeve , për kategoritë Mallra dhe shërbime, Komunal Subvencione , dhe Shpenzime kapitale .
- Çertifikimin dhe aprovimin e të gjitha lëndëve për pagesa të ndryshme , deri më tani janë çertifikuar - aprovuar dhe proceduar për pagesë në Freebalanc gjithsej **1,128** - lëndë të programeve dhe të kategorive të ndryshme ekonomike,ku gjithsej janë **312** - çertifikime – aprovime me Modul të Blerjes , ndërsa **816** çertifikime – aprovime me Modul të Aprovimeve. Pagesat janë bërë për kategoritë Mallra dhe shërbime, Komunal ,Subvencione dhe Shpenzime kapitale.

- Shpenzimi i lendeve gjate periudhes Jajar-Dhjetor **2020**.
Gjate kesaj periudhe vjetore, ne sistemin e Free Balancit jane bere shpenzim keto lende ne keto module:
Moduli i Blerejes gjithsejte **312** lende, ndersa
Moduli i Aprovimit **816** lende.

❖ **Spektori i Tatimit nē Pronē**

Raporti vjetor i vitit 2020 Zyra e Tatimit nē Pronē ka qenē e gatshme gjithmon për shērbime ndajē qytetareve, për sqarime dhe konsultime të ndryshme në bazē nevojave që janë paraqitur.

Te hyrat e Tatimit mbi Pronē gjatē muajve Janar-Dhjetor 2020 janë gjithsej **61,390.79 €**

Kemi lëshuar vërtetime për kryerjen e obligimeve siç janë :

- Vërtetime për regjistrim automjeteve
- Vërtetime për Gjeodezi dhe Kadastër
- Vërtetime për Çertifikat Vendbanimit
- Vërtetime për Subvencionime
- Vërtetimeve për rregullimin e dokumentacioneve të ndryshëm, ku të gjitha janë lëshuar nga sistemi me funksionin „shtype certifikatën e pagesë,, ku gjithsej janë **919** vërtetime, gjithashtu kemi lëshuar dhe **5** vërtetime per jo tatimpagus te cilët nuk kanë prone te regjistruar ne programin e tatimit PROTAX.

Gjatē muajit janar 2020, disa tatimpagues të cilët kanë pasur borgje të mëdha i kemi dërguar tek përmbaruesi.

Kemi bërë verifikimin e bizneseve për ta kontrolluar gjendjen se a janë hapur ende apo janë mbyllur, ku gjithsej janë verifikuar 127 biznese ekzistuese dhe kemi bërë edhe regjistrimin e bizneseve të reja, gjithsej janë regjistruar 4 biznese të reja në sistemin e Tatimit nē Pronē.

Gjithashtu gjatē muajit Shkurt kemi ndryshuar pikat e lokacioneve të ato Objekte të cilat kanë gjenë gabim mbi 240 pika.

Në muajin Shkurt 2020 kemi shpërndarë fatuarat e tatimit në pronë .

Raport mbi shpërndarjen e faturave për vitin 2020			
Nr i faturave	Shpërndarja	Përqindja	Mbetja

1675	1626	97%	49
-------------	-------------	------------	-----------

Numri i faturave të kthyera		
1.	Klienti nuk ka pranuar	
2.	Adresa jo e saktë	20
3.	Klienti ka ndërruar vendbanimin	29
	Gjithsej të kthyera	49

Gjithashtu gjatë muajit Mars kemi hapur afatin e Ankesave 02.03.2020-02.04.2020 por pas nje pranimi të një Urdhërese nga Ministria e Financave për shtyrje të afatit të ankesave dhe pagesave e kemi lënë afatin e hapur deri në një Vendim tjetër.

Gjatë muajit Janar- Dhjetor kemi përgatitur edhe nje raport të ankesave të cilin e keni te bashkangjitur më poshtë .

Raporti i Ankesave gjate vitit 2020						
Llojet e pronës	Gjithsejt ankesa	Ankesat e miratuara	Ankesat e refuzuara	Rritja-zvoglimi m2	Gjithsej Efekti (- €)	Gjithsej Efekti(+€)
Rezidenciale	16	17	0		2879.13	12.62
Komerciale	1					
Industriale						
Rastet soc.						
Garazhat						
Tjera ankesa						
Totali	17	17	0	0	2879.13	12.62

Kemi informuar qytetarë përmes Webfaqes së Komunës dhe Faqen Zyrtare në Facebook për cdo ndryshim që kemi pranuar nga Ministria e Financave konkretisht Departamenti i Tatimit në pronë, për Shtyrjen e Afateve dhe denimet dhe interesi i cili ju shtyhet deri me 31Dhjetor2020.

Gjatë muajit Korrik ne si komision për rregullore të Tatimit në Pronë kemi mbajtur një takim ku ju kemi drejtuar komisionit Komunal për vlersimin e ofertave për vitin 2021.

Gjithashtu gjatë këtij muaji i kemi njoftuar tatim paguesit të cilet kan borgje ndaj Komunës gjegjësisht zyrës së Tatimit në Pronë të bëjnë pagesat ose do te marrim masa të tjera të cilat parashihen sipas ligjit dhe udhëzimeve administrative.

Zyra e Tatimit në Pronë me datën 24.07.2020 ka pranuar raportin e inspektimit nga Ministria e Financave, DTP ku nga tre rekomandimet që i kemi pasur nga viti 2018 i kemi plotësuar të gjitha.

Gjatë muajit Gusht kemi bërë planin e Rianketimeve të 1/5 e objekteve të cilat tatimohen për vitin 2020 dhe gjithsej janë 296 prona që janë rianketuar.

Plani i Rianketimit ose (modifikimit) të 1/5 e Objekteve që Tatimohen për vitin 2021

Duke u bazuar ne Ligjin e Tatimit ne Prone Nr.06/L-005, Udhëzimin Administrativ për Mbledhjen dhe Regjistrimin e Informatave mbi Pronën dhe Tatimpagusin dhe neni 15, Zyra e Tatimit në Pronë per çdo vit është e obliguar të bëjë verifikimin në teren 1/5 ose 20% e Objekteve të Regjistruara në Tatimin në Pronë.

Prandaj Komuna e Junikut për vitin 2021 do të Rianketoj lagjet “Agim Ramadani” ,”7 Shtatori” , “Krasniq” dhe “Gacafer”, ku numri i njësisë së objekteve që Modifikohen janë **340** njësi të objektit.

Nr	Lagjet të cilat do te verifikohen janë	Zyrtart	Koha e Zbatshmerisë
1	Lagjia Agim Ramadani	Afrim Gjota	Shtator-Nëntor 2021
2	Lagjia 7 Shtatori, Krasniq,Gacafer	Xufe Jasiqi	Shtator-Nëntor 2021

Gjatë vitit 2020 kemi bërë verifikim e pronave dhe gjithsej 42 prona kanë pasur ndryshime. Po ashtu kemi bërë edhe regjistrimin e pronave të reja ku gjithsej kemi regjistruar 50 prona të reja gjatë vitit 2020.

Gjithashtu gjatë muajit Shtator 2020 kemi miratuar normat e reja Tatimore për vitin 2021 sipas Ligjit të Tatimit në pronë 06/ L-005 neni 9 ku thuhet që Kuvendi Komunal mund ti ndryshoj Normat Tatimore për gjitha pronat e Paluajtshme në tërë territorin e Komunës së Junikut . Ky vendim ka kaluar me përkrahjen e gjithë asambleistave .

Tabela 2: Normat Tatimore sipas kategorisë së Pronës për vitin 2021

Kategoria e Pronës	Normat Tatimore
Për njësitë bujqësore të parcelave	0.15%
Për njësitë bujqësore të objekteve	0.15%
Për njësitë pyjore të parcelave	0.15%
Për njësitë rezidenciale të parcelave	0.15%
Për njësitë rezidenciale të objekteve	0.15%
Për njësitë komerciale të parcelave	0.15%
Për njësitë komerciale të objekteve	0.15%
Për njësitë industriale të parcelave	0.15%
Për njësitë industriale të objekteve	0.15%

Gjithashtu gjatë muajit Nëntor kemi shpërndarë vërejtjet e para për tatimpaguesit që kanë pasur borgje të mëdha.

Gjatë muajit Dhjetor kemi realizuar të hyra **10,587.17**, gjithashtu kemi pasur takim me Zyrtarët e departamentit të tatimit në pronë ku na kanë njoftuar për ndryshimet që kanë ndodhur në faturat e tatimit në pronë dhe ndryshimin e zonave për prona Komerciale industriale.

Kemi përgaditur 15 Aktvendimet për tatimpaguesit të cilët kanë pasur borgje ndaj tatimit në pronë dhe pas përfundimit të afatit këto i përcillen përmbaruesit.

Trajnimet e ndjekura gjatë kësaj periudhe Janar-Dhjetor 2020, nga stafi i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa janë .

- Sistemet e brendshme te kontrollit dhe menaxhimi i riskut
- Planifikimi dhe buxhetimi i investimeve kapitale
- Qasjet dhe teknikat ne procesin e menaxhimit te projekteve
- Sfidat e menaxhimit te raportimit financiar
- Menaxhimi i taksave dhe Planifikimi i te Hyrave Vetanake
- Sistemi i zhvillimit dhe menaxhimit te buxhetit
- Buxheti dhe huamarrja komunale
- Trajnim ne BDMS dhe PIP.

Me datë 18.02.2020 ka marr pjesë Menaxheri i Tatimit në Pronë në një trajnim me Asosacionin e Komunave të Kosovës i cili u mbajtë në Prizeren. Diskutimet ishin për udhëzime administrative, Ligji për pushtetin lokal, Ligji mbi Partneritetin publiko privat, Ligji per pyje dhe ujitje.

Gjithashtu me datë 20.02.2020 trajnime për Grandin e Përformancës- Mjedisi i Pastër.- Menaxheri i Tatimit në Pronë.

Me datën 28.02.2020 ka marr pjesë në Planin Zhvillimor Komunal në Junik.- Menaxheri i Tatimit në Pronë.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa gjate kësaj periudhe i ka pranuar gjithsejtë 1,185 shkresa hyrëse dhe dalëse.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa vlen të ceket që edhe pse ishte një vit i jashtëzakonshëm pune, për shkak të pandemisë globale COVID -19, ka arritur që të gjitha punët dhe detyrat e parapara me planin e punës ti kryej me një përkushtim të madh dhe me sukses.

Sugjerimet tona të cilat mendojmë se do ta rrisin performancën e punës në Drejtorinë tonë janë vazhdimi i trajnimeve për zyrtarët.